



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 20.09.2018

Dokument parlamentar

**RAPORT
PËR**

**PROJEKTLIGJIN “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 102/2015, “PËR SEKTORIN
E GAZIT NATYROR””**

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, në mbledhjen e datës 20 Shtator 2018.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishin znj. Dorina Cinari, zëvendësministre në ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe përfaqësues të kësaj ministrie.

Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” është një nismë e Këshillit të Ministrave, e cila i paraqitet për shqyrtim Kuvendit.

Qëllimi i projektligjit është saktësimi i formulimit të fjalisë së parë, të pikës 2, të nenit 89, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

Ky saktësim propozohet për shkak se përmbajtja e pikës 2, të nenit 89, të ligjit konsiderohet si gabim/lapsus, pasi objekti i nenit 89 ka të bëjë me miratimin e kushteve dhe të procedurave për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik.

Me qëllim për ta përshtatur atë plotësisht me përmbajtjen e vet nenit 89, të ligjit që ka si objekt vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, në veprimtaritë lidhur me transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin me gaz natyror, propozohet që fjalia e parë e pikës 2, të nenit 89, të ligjit nr. 102/2015, të formulohet : “*Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton kushtet dhe procedurat për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik.*”.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni, e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare.

RELATOR

Besnik BARAJ

KRYETAR

Eduard SHALSI